



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

RAPORTI VJETOR

PËR VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT NË VITIN 2024

asd.gov.al



Tryeza e lëndës

Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti	4
1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm.	5
1.2. Përmbledhje Ekzekutive.	9
Seksioni 2 – Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë	11
Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri	27
3.1. Depozitat në banka dhe SHKK.	27
3.2. Sigurimi i depozitave në banka.	28
3.2.1. Depozitat e sigurueshme në sistemin bankar.	28
3.2.1.1. Depozitat e sigurueshme të individëve.	31
3.2.1.2. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.	34
3.2.2. Depozitat e siguruara në sistemin bankar.	36
3.2.2.1. Depozitat e siguruara të individëve.	37
3.2.2.2. Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare.	38
3.3.1. Depozitat e sigurueshme në SHKK.	40
Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të ASD-së	44
4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.	44
4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.	44
4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.	44
4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka.	46
4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK.	47
4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.	47
4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.	47
4.2.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në SHKK.	49
4.3. Administrimi i mjeteve financiare.	49
Seksioni 5 – Plan i Strategjik 2024-2026 dhe aktivitete për vitin 2024	52



5.1. Plani Strategjik 2024-2026.	52
5.2. Aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut dhe edukimin financiar.	54
5.2.1. Pjesëmarrje në aktivitetet e edukimit financiar.	54
5.2.2. Leksione të hapura.	55
5.2.3. Promovim i skemës përmes informimit për depozituesit në degët e bankave.	56
5.3. Aktivitete në rrafshin ndërkombëtar.	56
5.3.1. Kontributi në forumet ndërkombëtare.	57
5.3.2. Bashkëpunimi me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Hungarisë.	58
5.3.3. Bashkëpunimi me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Kosovës.	59
Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës.	60
6.1. Këshilli Drejtues.	60
6.2. Struktura organizative.	61
Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.	63
Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.	70
8.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.	70
8.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.	72



Seksioni 1 – Rreth këtij Raporti

Raporti Vjetor 2024 ofron një panoramë të veprimtarisë financiare dhe administrative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 1 janar 2024 deri në 31 dhjetor 2024. Ky Raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me Ligjin nr. 39/2016 dhe Ligjin nr. 132/2016, Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018, Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për Vitin 2022”, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2024 si dhe performancën e saj financiare e flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë. Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF-të”). Bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë auditohen dhe certifikohen nga auditues të jashtëm të specializuar.

Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Këshilli Drejtues ka ushtruar tagrat që i jep ligji për t’u siguruar që raporti vjetor dhe pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën dhe administrimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit në raportim.

Jeni të lutur të jepni komentet tuaja për Raportin Vjetor 2024 në adresën info@asd.gov.al. Ky Raport Vjetor, si dhe raportet vjetore të mëparshme, mund të konsultohen në faqen tonë zyrtare të internetit www.asd.gov.al.



1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm.


Të nderuar lexues,

Me kënaqësi ju prezantojmë, si çdo vit, Raportin Vjetor të institucionit tonë për vitin 2024. Edhe në këtë vit zhvillimet kanë qenë pozitive për ekonominë shqiptare dhe për sektorin bankar në veçanti, duke reflektuar përpjekjet tona të përbashkëta për të garantuar stabilitetin financiar dhe mbrojtjen e depozituesve.

Kështu, ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje të qëndrueshme, duke gjeneruar më shumë punësim, paga më të larta dhe të ardhura të shtuara për familjet dhe bizneset. Inflacioni ka mbetur i ulët dhe nën kontroll, duke arritur në nivelin 2.2%, çka ka lehtësuar barrën e kostove për qytetarët dhe ka krijuar një mjedis financiar nxitës për zhvillimin ekonomik.

Paralelisht, sektori bankar ka shfaqur qëndrueshmëri dhe tregues financiarë në përmirësim. Raporti i kredive me probleme ka pësuar një rënie të ndjeshme përgjatë këtyre 10 viteve të fundit, nga thuhet 23% në 4.2%, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm në cilësinë e portofolit të kredisë. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ka shënuar një nivel mesatar prej 18%, duke treguar forcimin e kapaciteteve financiare të sektorit bankar. Bankat kanë vijuar të kreditojnë ekonominë, duke mbajtur një nivel të lartë likuiditeti dhe rentabiliteti, duke forcuar më tej besimin e publikut.

Depozitat në sistemin bankar kanë shënuar një rritje prej 4,9%, ose 78,2 miliardë lekë më shumë se në vitin 2023, numri i depozituesve të siguruar ka pasur një rritje vjetore me rreth 144.000 depozitues, duke bërë që fondi i sigurimit të depozitave të rritet me 10.3%, edhe si pasojë e rritjes së të ardhurave nga aktiviteti investues me 20.74%, çka reflekton besimin e publikut në sistemin bankar.



Në këtë kontekst pozitiv, Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka vijuar të zbatojë me përkushtim dhe efikasitet prioritetet e saj strategjike, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe operacionale në funksion të përmbushjes së mandatit ligjor.

Gjatë vitit 2024, bazuar në rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë si dhe në udhëzimet e strukturave drejtuese, Agjencia ka përmirësuar infrastrukturën e saj teknike dhe kapacitetet njerëzore, duke investuar në përgatitjen e stafit dhe teknologji për të garantuar një reagim të shpejtë dhe efikas në rast të një ngjarjeje kompensimi. Sa më sipër, është punuar intensivisht në përmirësimin e kapaciteteve të mbikëqyrjes dhe analizës së rreziqeve përmes ushtrimeve teknike të simulimit dhe verifikimeve, ndërveprimit të vazhdueshëm konstruktiv me bankat dhe shoqëritë e kursim kreditit, duke forcuar kështu mekanizmat e mbrojtjes së depozituesve.

Gjithashtu, vëmendje i kemi kushtuar edhe informimit në vazhdimësi dhe rritjes së edukimit financiar në grupet e interesit. Strukturat përkatëse të Agjencisë kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë kontribut në aktivitetet edukimit financiar të organizuara nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave. Për më tepër, duke vlerësuar që punonjësit e degëve të bankave kanë një rol thelbësor në informimin e depozituesve, jemi angazhuar në takime të rregullta rajonale me ta, duke synuar rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e informimit të saktë të depozituesve mbi skemën e sigurimit të depozitave dhe tiparet e saj.

Një nga iniciativat kryesore ka qenë hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik 2024-2026, i cili përcakton drejtimet strategjike që Agjencia do të ndjekë në periudhën afatmesme. Në hartimin e këtij plani, kemi konsideruar me kujdes realizimin e objektivave të planit të kaluar dhe jemi bazuar në objektivat publike të skemës së sigurimit të depozitave, që qëndrojnë në themel të veprimtarisë sonë.



Për trevjeçarin 2024-2026, prioritetet strategjike të Agjencisë janë:

1. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore për përmbushjen e objektivave institucionale.
2. Garantimi i komunikimit efektiv me grupet e interesit përmes ndërveprimit me anëtarët e skemës dhe aktorë të tjerë të identifikuar.
3. Harmonizimi në vazhdimësi me legjislacionin evropian, në kuadër të Programit Kombëtar për aderimin në Bashkimin Evropian.

Duke u fokusuar në këto tre drejtime strategjike, jemi besimplotë se aktivitetet dhe iniciativat e përcaktuara do të na mundësojnë të përmbushim në mënyrë efikase mandatin tonë ligjor.

Theksojmë rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Shoqatën e Bankave, si dhe anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave (bankat dhe shoqëritë kursim-krediti) për realizimin me sukses të prioriteteve strategjike të Agjencisë. Në kuadër të këtij Plani Strategjik, Agjencia angazhohet të rrisë nivelin e kapaciteteve të saj operacionale në funksion të përgatitjes me efikasitet për një ngjarje kompensimi, si dhe për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi përfitimet e sigurimit të depozitave.

Duke marrë në konsideratë se në vitin 2024 nisi procesi zyrtar i negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Agjencia ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të qenë në të njëjtin ritëm me angazhimet e Qeverisë Shqiptare në këtë drejtim. Ashtu siç është parashtruar në strategjinë afatmesme, në konsultim me partnerët ndërkombëtarë dhe bashkërendim me autoritetet rregullatore shqiptare, kemi nisur punën për adresimin e çështjeve që do të na përafrojnë me legjislacionin e BE-së për sigurimin e depozitave.



Duke qenë të ndërgjegjshëm për sfidat rregullatore, legislative dhe institucionale, jemi të sigurtë se aftësia e strukturave të Agjencisë e bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave janë një garanci për përmbushjen e këtij angazhimi institucional brenda parametrave të përcaktuar nga Qeveria Shqiptare.

Në mbyllje, bazuar në sa më sipër dhe projeksionet tona, rikonfirmojmë besimin se sistemi financiar në Shqipëri do të mbetet i sigurtë për depozituesit, falë mbikëqyrjes së fortë dhe masave legislative e rregullatore të institucioneve financiare dhe menaxhimit të kujdesshëm të riskut nga anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave.


Ju faleminderit.

Donald Duraj

Kryetar i Këshillit Drejtues

Genci Mamani

Drejtor i Përgjithshëm




1.2. Përmbledhje Ekzekutive.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2024, ka siguruar depozitat e vendosura nga depozituesit në 11 banka dhe 9 shoqëri kursim krediti (SHKK).

Për fundin e vitit 2024, totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1,683 mld lekë me një rritje vjetore të tyre prej 4.9 %. Detyrimi i Agjencisë për kompensim në fund të këtij viti ishte 921 mld lekë, për 1,986,871 depozitues bankash. Në fund të vitit 2024, vlera e depozitave të sigurueshme që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,590.2 mld lekë, duke përfaqësuar 94.5% të totalit të depozitave. Krahësohet me një vit më parë këto depozita u rritën me 5.2%, ndërsa rritja në vlerë absolute është 78.9 mld lekë. Depozitat e sigurueshme në euro të shprehura në kundërvlerën në lek, për fundin e vitit 2024, zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme prej 47.4% të këtij totali, ndjekur nga depozitat në lekë me peshë 46.9%, dhe nga depozitat në USD me kundërvlerën e tyre në lekë me 4.1%. Depozitat e sigurueshme të individëve në sistemin bankar për fundin e vitit 2024 arritën në 1,275.4 mld lekë, duke përfaqësuar 80.2% të totalit të depozitave të sigurueshme. Në fund të vitit 2024 depozitat e siguruara në sistemin bankar ishin 54.7% e totalit të depozitave në sistemin bankar dhe 57.9% e depozitave të sigurueshme. 92.9% e depozituesve në banka kompensohen plotësisht.

Totali i depozitave në SHKK për fundin e vitit 2024 ishte 11.5 mld lekë, nga 10.9 mld lekë që ishte në fund të dhjetorit 2023. Depozitat e sigurueshme janë 11.3 mld lekë dhe zënë 98,4% të totalit të depozitave, kundrejt 10.8 mld lekë që ishin një vit më parë. Këto depozita i korrespondojnë 44,270 depozituesve të SHKK-ve në fund të vitit 2024. Depozitat e sigurueshme, gjatë vitit 2024 janë rritur me 4.8%. Në këtë rritje ndikimin më të madh e ka dhënë rritja e depozitave në lekë. Depozitat në lekë zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme të SHKK-ve, 77.2%. Rritja vjetore e tyre është 5.4%. Në fund të vitit 2024, depozitat e siguruara në SHKK janë 8.1 mld lekë, sa 70% të totalit të depozitave, ose 71% të depozitave të sigurueshme. 91% e depozituesve në SHKK kompensohen plotësisht.



Fondet e sigurimit të depozitave në banka dhe në shoqëritë e kursim-kreditit kanë pasur një rritje të qëndrueshme gjatë vitit 2024. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e këtyre fondeve janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare. Në 31 dhjetor 2024, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, është 70.1 mld lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me rreth 6.5 miliard lekë ose 10.3%. Të ardhurat nga primet e sigurimit të paguar nga bankat, për vitin 2024 ishin 4.39 miliard lekë ose 5.4% më të larta se në vitin 2023. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për 2024 ishin 2.83 miliard lekë ose 20.7% më shumë se një vit më parë. Rritja e të ardhurave për vitin 2024 lidhet me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të titujve. Në fund të vitit 2024, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 7.61%.

Në fund të vitit 2024, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, është rreth 256.9 mln lekë duke shënuar një rritje prej 15.3% krahasuar me vitin 2023. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2024 ishin 23.49 milion lekë e cila krahasuar me vitin 2023 është rritur me 6.22 %. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK gjatë vitit 2024 ishin në shumën 10.95 milion lekë e cila krahasuar me vitin 2023 është rritur me 22.71 %. Në fund të vitit 2024, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 3.19%.

Gjatë vitit 2024, Agjencia ka ushtruar përgjegjësinë ligjore për administrimin e FNJ, në përputhje me aktet e miratuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë. Kontributi vjetor i paguar nga bankat për vitin 2024, ka qenë në vlerën 982.1 mln lekë. Në 31 dhjetor 2024, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të ANJ është 5.73 mld lekë.



Seksioni 2 – Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë përcakton drejtimet në të cilat Agjencia duhet të fokusohet për të përmirësuar aspekte të caktuara të aktivitetit të saj. Për këtë qëllim, rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit janë pjesë e qenësishme e planifikimeve të objektivave strategjike të institucionit e si rrjedhojë në vëmendje të të gjitha strukturave. Në vijim, prezantohen në detaje të gjitha veprimet e ndërmarra nga Agjencia për adresimin e rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, të cilat vlerësohet se janë përmbushur më sukses.

Rekomandimi


Të intensifikojë punën në drejtim të sigurimit të gatishmërisë institucionale për kompensimin efektiv të depozituesve nëpërmjet ushtrimit të testimeve, të simulimeve teknike dhe bashkëpunimit me bankat dhe SHKK-të anëtare të skemës në këtë drejtim.

1. Simulime teknike.

Agjencia gjatë vitit 2024, ka vijuar kryerjen e simulimeve teknike me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, banka dhe shoqëri kursim-krediti, për raportimin dhe ngarkimin e saktë në sistemin e Agjencisë, të skedarëve për simulim/kompensim për paraqitjen unike të depozituesve nga bankat dhe shoqëritë e kursim-krediti.

Veprimet e ndërmarra nga ASD


Gjatë kryerjes së simulimeve teknike me subjektet anëtare, Agjencia, nëpërmjet kontrolleve të kryera nga sistemi i saj Informatik për Raportim dhe Kompensim, ka vlerësuar saktësinë e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në rast ngjarjeje sigurimi, ose për qëllim simulimi. Gjithashtu këto simulime teknike kanë qenë pjesë edhe e verifikimeve që ASD ka kryer në subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, konkretisht për verifikimin e gatishmërisë së raportimit të skedarëve për simulim/kompensim, si dhe të saktësisë së të dhënave të depozituesve, që do të kompensohen në rast të një likuidimi të detyruar të një subjekti anëtar të



skemës. Në rastet kur nga këto simulime janë konstatuar pasaktësi, ASD ka bashkëpunuar me stafin përgjegjës të subjekteve për ndreqjen e gjetjeve të evidentuara deri sa ngarkimi i skedarëve ka rezultuar me sukses. Në përfundim të procesit të verifikimit, Agjencia ka dërguar raportin e verifikimit, pjesë e të cilit janë edhe rekomandimet për punën në vijim.

2. Përzgjedhja e bankave agente për kryerjen e procesit të pagesave në rast ngjarje sigurimi.

Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e ASD-së, procesi i kompensimit do të kryhet nëpërmjet një ose disa bankave të përzgjedhura nga sistemi bankar, të cilat konsiderohen si banka agente. Roli i tyre në proces lidhet me kryerjen e pagesave për depozituesit e siguruar në përputhje me listë-pagesën dhe fondet e dërguara nga ASD. Për këtë arsye, përzgjedhja e këtyre bankave ka rëndësi thelbësore për kryerjen e një procesi kompensimi efektiv.



Duke u bazuar në përcaktimet ligjore dhe rregullative, ASD ndërmori procesin e përzgjedhjes së bankave agente për periudhën 2024-2026.




Procesi, i cili kalon nëpër disa faza dhe përfshin edhe bashkëpunimin si me Bankën e Shqipërisë ashtu edhe me bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave që shprehin interes për të kryer këtë rol, u finalizua me përzgjedhjen e katër bankave agjente. Këshilli Drejtues me vendimin nr. 18, datë 30.07.2024 përzgjodhi si banka agjente në listën paraprake Bankën OTP Albania sh.a, Bankën Kombëtare Tregtare sh.a, Bankën Intesa Sanpaolo Albania sh.a dhe Bankën Credins sh.a. Në vijim, gjatë muajit shtator 2024 u nënshkruan kontratat për ofrimin e shërbimit të kompensimit të depozitave të siguruara ndërmjet ASD-së dhe bankave agjente të përzgjedhura.

Në vijim të përzgjedhjes në listën paraprake, bankat agjente do të jenë pjesë e ushtrimeve të simulimit, si dhe të trajnimeve të posaçme për të realizuar me sukses një proces të pagesave për kompensimin e depozituesve.

3. Takime me subjektet anëtare të skemës.

Agjencia në vijim të bashkëpunimit të vazhdueshëm me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave me synimin për të përmbushur me sukses mandatin e saj për kompensimin efikas të depozituesve dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, ka kryer takime rajonale me drejtuesit dhe punonjësit e degëve të bankave si edhe SHKK-ve në Fier, Berat, Lushnje, Gjirokastrë, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Korçë, Pogradec, Bilisht dhe Ersekë. Kjo shpërndarje gjeografike e planifikuar synonte kontaktimin e punonjësve të degëve të bankave dhe SHKK-ve në pothuajse të gjitha qendrat urbane ku vlerësohet se është dhe përqendrimi më i madh i degëve të institucioneve financiare pjesë e skemës së sigurimit të depozitave. Objekti i takimeve dhe tematikat e trajtuara lidhen me ndërgjegjësimin e punonjësve të bankave/SHKK-ve për rolin e tyre të rëndësishëm në mirëfunksionimin e skemës së sigurimit të depozitave, duke qenë të mirinformuar për tiparet e skemës si dhe duke informuar depozituesit përkatësisht sa i takon përfitimeve dhe kufizimeve që burojnë nga skema e sigurimit të depozitave. Në këto takime është theksuar



roli i punonjësve të bankës në aktivitetin e përditshëm për hedhjen e plotë dhe të saktë të të dhënave për depozituesin dhe depozitën, për standardizimin e mbajtjes së të dhënave për depozitat e sigurueshme; paraqitjen unike të depozituesve (SCV); simulimet teknike si edhe informimin e saktë të depozituesit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave. Vëmendje e veçantë iu kushtua rolit që kanë punonjësit e bankës agjente në një ngjarje sigurimi për kryerjen e shpejtë dhe të saktë të procesit të pagesave për kompensim, si edhe për informimin e saktë të depozituesit për procesin e kompensimit të depozitave.

**Statusi**

Realizuar

Rekomandimi

Të kontribuojë në avancimin e skemës së sigurimit të depozitave duke e përafruar brenda vitit 2024 kuadrin rregullator me skemat evropiane të sigurimit të depozitave, përmes adresimit të çështjeve që nuk përputhen me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”.

1. Ndryshime të kuadrit rregullator të ASD-së.

**Veprimet e
ndërmarra
nga ASD**

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë me Vendimin nr. 2680, datë 20.06.2024 miratoi shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren nr. 3762, datë 18.7.2016 “Për kompensimin e depozitave të siguruar”, të propozuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Rishikimi i këtij akti nënligjor është pjesë e prioriteteve të përcaktuara në Planin Strategjik për vitin 2024. Shtesat



dhe ndryshimet e miratuara përmirësojnë shkallën e përafrimit të kuadrit rregullator vendas me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”, si dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të fushës së sigurimit të depozitave. Për këtë qëllim, ASD mori asistencën teknike të FinSAC të Bankës Botërore, si dhe i rishikoi dispozitat në fuqi nëpërmjet një procesi transparent në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, përfaqësues të bankave anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe të bankave agjente. Një nga ndryshimet kryesore të miratuara në këtë rregullore që adreson një nga çështjet më thelbësore që përbëjnë mospërputhshmëri me direktivën e BE-së ka të bëjë me shkurtimin e afatit për fillimin e procesit të pagesave për kompensimin e depozitave, nga “brenda 20 (njëzet) ditëve pune” në “brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve pune”. Ky ndryshim vjen si rezultat i përmirësimit të kapaciteteve operacionale dhe financiare të Agjencisë, për të përmbushur funksionin e saj ligjor për kompensimin e depozitave, nëpërmjet:

- qasjes së Agjencisë në likuiditet nëpërmjet kontratës për riblerjen e titujve nënshkruar me Bankën e Shqipërisë;
 - operacionalizimit të procesit të huamarrjes nëpërmjet marrëveshjes “Për përdorimin e mbështetjes financiare publike për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe kompensimin e depozitave për ruajtjen e stabilitetit financiar”, hartuar në bashkëpunim dhe nënshkruar në vitin 2024 nga Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave;
 - përmirësimeve të kryera në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit; si dhe
 - përvojës nga ushtrimet e simulimit të kryera ndër vite.
-



-
2. Projekti me BERZH për hartimin e metodologjisë të pagesave të primit me bazë rreziku.

Në kuadër të programit strategjik të Qeverisë Shqiptare për integrimin evropian, Agjencia ka nisur punën për adresimin e çështjeve që përbëjnë pa përputhshmëri me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”. Një nga çështjet kryesore, lidhet me aplikimin e primit me bazë rreziku për subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Në këtë drejtim Agjencia, me asistencën e BERZH, ka përfunduar projektin për hartimin e metodologjisë së përlllogaritjes së primit me bazë rreziku. Qëllimi i metodologjisë është aplikimi i primeve të diferencuara për subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, në përputhje me rrezikun që këto subjekte mbartin. Mënyra e përlllogaritjes është hartuar duke u bazuar në udhëzimet e rishikuara rishtazi nga EBA (European Banking Authority) për këtë qëllim. Primi me bazë rreziku dhe metodologjia e përlllogaritjes sipas përcaktimeve europiane përbëjnë elemente thelbësore të ndryshimeve ligjore që synojnë rritjen e përputhshmërinë e skemës së sigurimit të depozitave, me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”.

3. Përditësimi me ndryshimet e pritshme në Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”.


Harmonizimi i legjislacionit shqiptar për sigurimin e depozitave me acquis të BE-së është një nga prioritetet strategjike të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. ASD-ja, si një institucion publik, është pjesë e procesit të anëtarësimit në BE dhe është përfshirë në kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Ky proces lidhet kryesisht me përputhshmërinë e kuadrit rregullator për



sigurimin e depozitave me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, ASD në vazhdimësi ka vijuar me përpjekjet në drejtim të adresimit të çështjeve që përbëjnë mospërputhshmëri me direktivat e BE-së. Gjithsesi, përpjekjet e ASD ndikohen dhe nga zhvillimet në mjedisin rregullativ të BE-së. Zhvillimi kryesor në këtë drejtim lidhet me reformën ligjore që Komisioni Evropian ka ndërmarrë me qëllim forcimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e krizave financiare dhe skemat e sigurimit të depozitave. Kjo reformë parashikohet të sjellë ndryshime thelbësore në Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave” dhe Direktivën 2014/59/BE “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet financiare”. Projekt propozimet e Komisionit Evropian për ndryshimin e kuadrit ligjor për sigurimin e depozitave dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme synojnë, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe mbrojtjen e të ardhurave të taksapaguesve, mbrojtjen e ekonomisë nga ndikimi që mund të ketë falimentimi i institucioneve bankare si dhe mbrojtje më efektive për depozituesit.

Duke vlerësuar ndikimin dhe rëndësinë që këto ndryshime kanë për vijimësinë e procesit të përputhshmërisë, ASD në bashkëpunim me zyrën FinSAC të Bankës Botërore organizoi një takim informativ me ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme për Stabilitetin Financiar, Shërbimet Financiare






dhe Unionin e Tregjeve të Kapitalit (DG FISMA), i cili është departamenti përgjegjës i Komisionit Evropian për politikën e BE-së për shërbimet financiare. Përfaqësuesi i DG FISMA ofroi një panoramë të kontekstit në të cilin janë propozuar ndryshimet e pritshme në kuadrin ligjor të BE-së për menaxhimin e krizave financiare dhe skemat e sigurimit të depozitave. Takimi u fokusua gjithashtu në përshtatshmërinë e këtyre ndryshimeve dhe përputhshmërinë e tyre me kuadrin ligjor dhe rregullativ për sigurimin e depozitave dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Republikën e Shqipërisë. Gjykohet se takimi me DG FISMA ishte i nevojshëm për përditësimin me ndryshimet e pritshme në Direktivat e BE-së, me qëllim ndërmarrjen e iniciativave të koordinuara ligjore në drejtim të hartimit të një pakete ligjore gjithëpërfshirëse dhe në përputhshmëri me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian.

4. Projekt me zyrën FinSAC të BB për asistencë teknike në bashkërendimin e të gjithë projekteve të mëparshme dhe hartimin e paketës ligjore që do të adresojë çështjet e mospërputhshmërisë me Direktivat e BE-së.

Në kuadër të procesit të përafrimit ligjor dhe rregullativ me kuadrin e BE-së, ASD ka ndërmarrë në vazhdimësi projekte asistence teknike me institucionet financiare ndërkombëtare partnere. Bazuar në analizat e kryera në kuadër të këtyre projekteve, Agjencia ka evidentuar çështjet kryesore ku nuk është arritur ende harmonizim i plotë me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e sigurimit të depozitave”. Këtu përfshihet niveli i mbulimit të depozitave të siguruara, miratimi i një modeli të mbledhjes së primit të bazuar te rreziku, mbulimi i kategorive të caktuara të depozituesve, përcaktimi i një niveli të fondit të synuar, periudha e pagesës dhe dispozitat për balancat e larta të përkohshme. Në vijim të kësaj pune paraprake, si dhe duke marrë në konsideratë, angazhimet e Qeverisë Shqiptare në kuadër të Planit Kombëtar



për Integrimin Evropian 2025-2027, ASD synon të realizojë në bashkëpunim me ekspertët e FinSAC një projekt gjithëpërfshirës. Ky projekt do të bashkërendojë rezultatet e gjithë projekteve të asistencës teknike të mëparshme, si dhe do të analizojë në mënyrë të detajuar Ligjin Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”, me qëllim hartimin e një pakete ligjore të plotë, e cila përpara prezantimit për miratim në Kuvendin e Shqipërisë, do t’i nënshtrohet konsultimit dhe dakordësimit me autoritetet rregullatore dhe aktorët e sistemit financiar në vend. Aktualisht, ASD dhe zyra FinSAC e Bankës Botërore kanë përcaktuar modalitetet dhe termat e referencës në të cilat do të shtrihet ky projekt, duke synuar përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra nga Agjencia në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2025-2027.

Statusi Realizuar

Rekomandimi Të rrisë transparencën përmes publikimit të të dhënave dhe raporteve statistikore në formate dhe platforma lehtësisht të përdorshme nga publiku i gjerë.

Veprimet e ndërmarra nga ASD Agjencia në mënyrë të vazhdueshme ka punuar dhe ka vlerësuar cilësinë e informacioneve që shërbejnë dhe përbëjnë interes për publikun. Në zbatim të Rekomandimeve të Kuvendit por edhe të Planit Strategjik të ASD-së 2024-2026, Agjencia i ka rritur përpjekjet e saj në drejtim të një komunikimi transparent me publikun.

Një nga iniciativat kryesore që ASD ka realizuar këtë vit, në drejtim të informimit sa më të thjeshtë dhe transparent të publikut, lidhet me ridizenjimin e faqes zyrtare të internetit të Agjencisë. Ky ridizenjim nga ana vizuale ka siguruar një qasje më miqësore me vizitorët e faqes si dhe është



përshtatur me teknologjinë e kohës sa i takon sigurisë së rrjetit. Faqja e rikonceptuar tashmë ofron një strukturë të qartë, në të cilën informacionet që konsiderohen thelbësore për informimin e depozituesve janë lehtësisht të konsultueshme. Një tipar i ri që kontribuon në një akses më të lehtë nga publiku është disponueshmëria e faqes në pajisje mobile, si celularë apo tabletë.

Në këtë drejtim si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimin e Kuvendit struktura e faqes së ridizenjuar ofron informacion më të zgjeruar, duke rritur gamën e publikimit të të dhënave dhe statistikave. Për këtë qëllim janë krijuar menu dhe seksione specifike për publikimin e të dhënave dhe raporteve mbi ecurinë e depozitave në përgjithësi dhe për kategori të veçanta sipas klasifikimeve të ASD-së. Tashmë të interesuarit mund të konsultojnë në faqen e ASD-së, menunë “Statistika”, informacion lidhur me ecurinë e depozitave të sistemit bankar/SHKK-ve sipas kategorive të sigurimit, numrin dhe përqindjen e depozituesve të sistemit bankar/SHKK-ve që kompensohen plotësisht dhe pjesërisht, raportin e mbulimit të depozitave të siguruara në banka/SHKK që mbulohen nga fondi i sigurimit të depozitave. Të dhënat janë pasqyruar në format lehtësisht të perceptueshëm nga të gjithë personat e interesuar. Në funksion të transparencës me publikun dhe garantimin e aksesit të shpejtë në të dhëna kryesore të ASD-së, në faqen zyrtare të internetit është shtuar një seksion i ri “Të dhëna të hapura”, i cili ofron akses të shpejtë në informacione gjithëpërfshirëse për aktivitetin e ASD-së, siç janë raportet vjetore, planet strategjike, etj.

StatusiRealizuar



Rekomandimi

Të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë dhe palët e tjera të përfshira në proces me qëllim identifikimin dhe administrimin e rreziqeve kibernetike.


1. Krijimi i qendrës së dytë funksionale për sistemet IT qendrorë të Agjencisë, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe përmirësime në infrastrukturën teknologjike të ASD.

Në kuadër të rritjes së aftësive reaguese në raste të situatave të jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe incidentet kibernetike, Agjencia gjatë vitit 2024, ka zbatuar projektin për krijimin e një qendre të dytë funksionale për sistemet IT qendrore të Agjencisë, që do të sigurojë vazhdimin e punës në çdo rast.

Veprimet e ndërmarra nga ASD

Për këtë qëllim, Agjencia bashkëpunoi me Bankën e Shqipërisë përmes nënshkrimit të një kontratë huapërdorjeje për dhënien në përdorim, të një ambienti në godinën e Qendrës Kërkimore të Beratit, në pronësi të Bankës së Shqipërisë. Agjencia realizoi përmirësimet e nevojshme në ambientin e përcaktuar në kontratë, sipas standardeve të përshtatshme për struktura të Teknologjisë së Informacionit. Ky ambient shërbeu për vendosjen e pajisjeve të nevojshme për të përmbushur funksionin e kthimit në një situatë normale të sistemeve informatike primare të Agjencisë, në rast dështimi të tyre ose në rast të ndodhjes së një ngjarjeje madhore apo incidenti kibernetik.

Në këtë qendër u krye instalimi i pajisjeve dhe shërbimeve duke siguruar që funksionet kritike të institucionit, të vazhdojnë të funksionojnë në çdo komponent të tyre pavarësisht incidenteve serioze ose dëmtimeve që mund të ndërpresin shërbimet ose do të rikthehen në gjendje operacionale brenda një periudhe të shkurtër.




2. Masa parandaluese për shmangien e kërcënimeve kibernetike.

Në kuadër të masave për rritjen e sigurisë ndaj sulmeve kibernetike, Agjencia ka implementuar platformën që kryen mbledhjen dhe analizimin e logeve nga sistemet e sigurisë së informacionit. Në infrastrukturën teknologjike të Agjencisë, për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave kritike dhe sistemeve informatike të saj, janë të implementuara dhe funksionale sistemet e sigurisë për mbrojtjen perimetrale të rrjetit, mbrojtjen e përdorueseve fundorë dhe atyre në largësi, mbrojtjen e shërbimit e-mail, si dhe atë të menaxhimit të ngarkesës dhe sigurisë së aplikacioneve. Këto sisteme gjenerojnë dhe ruajnë log-e lokalisht në hapësirat e ruajtjes së tyre dhe kjo platformë shërben si një sistem i unifikuar dhe i qendëruar për menaxhimin dhe analizimin e tyre. Me anë të kësaj platforme, merret një pamje e qartë dhe e përditësuar e trafikut të rrjetit, duke mundësuar marrjen e masave parandaluese për të shmangur kërcënimet ose incidentet e mundshme kibernetike. Identifikimi i problematikave, eventeve të ndryshme të dyshimta në rrjet nga platforma dhe menaxhimi i alerteve nga stafi TI gjatë kësaj kohe, kanë përforcuar mbrojtjen e rrjetit, aplikacioneve, databazës, dhe serverave në Agjenci.

3. Auditimi nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

Në kuadër të rritjes së nivelit të sigurisë kibernetike, gjatë muajit korrik 2024, me asistencën dhe mbikëqyrjen e AKSK, u identifikuan dhe analizuan rreziqet e sigurisë kibernetike në Agjenci. Në vijim u përcaktuan masat e nevojshme të sigurisë kibernetike që duhet të ndërmarrë Agjencia për përmirësimin e infrastrukturës aktuale.

Agjencia është angazhuar për zbatimin e masave të rekomanduara nga AKSK, të cilat konsiderohet se do të na ndihmojnë në adresimin e çështjeve të identifikuara, duke rritur kështu nivelin e sigurisë në ASD ndaj rreziqeve




kibernetike. Përgjatë këtij viti stafi TI i Agjencisë është përfshirë në trajnimet e zhvilluara nga AKSK me synimin të rrisë ndërgjegjësimin dhe aftësitë praktike të personelit, për të ofruar sigurinë e nevojshme ndaj sulmeve aktuale që ndodhin në vend dhe në rajon.

4. Takime me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave mbi sigurinë kibernetike.

- Në zbatim të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë si dhe duke vlerësuar se adresimi i rreziqeve kibernetike në sektorin financiar është një sfidë që kërkon përpjekje të unifikuara nga të gjithë institucionet e përfshira, Agjencia në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, organizoi një takim ndërgjegjësues mbi rëndësinë e sigurisë



kibernetike në sistemin financiar. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe të gjitha bankave të sistemit bankar në vend. Qëllimi kryesor i takimit ishte adresimi i sfidave të përbashkëta në identifikimin dhe mitigimin e rreziqeve nga kërcënimet kibernetike. Diskutimet u përqendruan në ruajtjen e besimit të publikut në sistemin financiar, përmes rritjes së sigurisë së të dhënave dhe mbrojtjes së informacionit të depozituesve. Me qëllim përftimin nga eksperiencat më të mira në trajtimin efikas të rreziqeve kibernetike, në takim ishte i ftuar një ekspert i nivelit të lartë për sigurinë kibernetike në Departamentin e Thesarit të Shteteve të Bashkuara. Ai prezantoi një panoramë të gjerë mbi rreziqet kibernetike, standardet ndërkombëtare rregullatore si dhe mënyrat



se si Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, mund të kontribuojë në forcimin e sigurisë së informacionit që lidhet me depozitat. Pjesëmarrësit ndanë përvojat dhe praktikatat më të mira në adresimin e rreziqeve kibernetike dhe diskutuan mënyrat më efikase të bashkëpunimit për të garantuar një mbrojtje të fortë kundër sulmeve të mundshme kibernetike. Ky takim është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së ndërgjegjësimit dhe forcimit të kapaciteteve në përballjen me sfidat kibernetike, duke kontribuar në mënyrë aktive për një sistem financiar më të sigurt dhe të qëndrueshëm. Në vijim të këtij takimi Agjencia u bë pjesë e platformës MISP, e cila menaxhohet nga Shoqata Shqiptare e Bankave dhe ku bëjnë pjesë Banka e Shqipërisë dhe bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. MISP është një platformë që shërben për identifikimin dhe raportimin e kërcënimeve kibernetike në sektorin bankar.

- Gjithashtu, në kuadër të ndërgjegjësimit të vazhdueshëm për sigurinë e informacionit dhe shmangien e incidenteve kibernetike, Agjencia ka përfshirë si pjesë të temave për diskutim në takimet rajonale me bankat dhe SHKK-të, rëndësinë për forcimin e angazhimit tonë të përbashkët ndaj sigurisë kibernetike dhe ruajtjen e infrastrukturës dixhitale. Në prezantimet e ofruara për audiencën si dhe në diskutimet pasuese u theksua më tej vëmendja dhe kujdesi që duhet treguar ndaj kërcënimeve të ndryshme kibernetike, duke qenë se është e domosdoshme që të qëndrojmë vigjilentë dhe proaktivë në ruajtjen e sigurisë së informacionit ndaj këtyre kërcënimeve keqdashëse.



Rekomandimi Të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë për harmonizimin e praktikave të ndërveprimit në funksion të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

1. Takim me Departamentin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë dhe ekspertë të zyrës FinSAC të Bankës Botërore.

Në kuadër të këtij rekomandimi të Kuvendit, ASD inicioi dhe organizoi në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë një takim pune me qëllim rritjen e efektivitetit në ndërveprimin institucional ndërmjet Departamentit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë dhe ASD-së në rastet e financimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në takim u analizuan në nivel teknik skenarët e

**Veprimet e
ndërmarra
nga ASD**



mundshëm të pjesëmarrjes së Agjencisë nëpërmjet transferimit të fondit të kompensimit të depozitave në banka në rast ndërhyrjeje të jashtëzakonshme, si dhe propozimet e pritshme në kuadër të reformimit të kornizës rregullatore të Bashkimit Evropian për menaxhimin e krizave financiare. Ekspertët e FinSAC ndanë përvojat dhe praktikat më të mira me fokus ndërveprimin e institucioneve për menaxhimin e krizave dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Zyrtarët pjesëmarrës në takim diskutuan mënyrat më efikase të bashkëpunimit dhe ndërveprimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë në funksion të ruajtjes së besimit të publikut në një sistem financiar të sigurt dhe të qëndrueshëm.



-
2. Takim me DG FISMA në kuadër të përditësimit me ndryshimet e pritshme në Direktivën 2014/59/BE “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet financiare”.

Reforma ligjore propozuar nga Komisioni Evropian për forcimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e krizave financiare dhe skemat e sigurimit të depozitave në një pjesë të konsiderueshme lidhet me mekanizmat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Duke marrë në konsideratë këtë fakt, ASD në takimin e organizuar me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme për Stabilitetin Financiar, Shërbimet Financiare dhe Unionin e Tregjeve të Kapitalit (DG FISMA) ftoi dhe përfaqësues të Departamentit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë. Takimi shërbeu si një platformë diskutimi në lidhje me përshtatshmërinë dhe adoptimin e ndryshimeve ligjore të kuadrit ligjor të BE-së në legjislacionin kombëtar dhe ndërveprimin institucional në rastet e përdorimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Statusi

Realizuar




Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri.

3.1. Depozitat në banka dhe SHKK.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2024 ka siguruar depozitat e depozituesve në 11 banka të sistemit, si dhe në 9 shoqëri kursim-krediti. Në fund të vitit 2024 totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1,683 mld lekë, ndërsa totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit ishte 11.5 mld lekë.

Totali i depozitave në banka dhe SHKK, për vitin 2024



Agjencia sipas të dhënave për fund vitin 2024 ka detyrimin për kompensimin e 921 mld lekë depozitave në banka, apo të 1,986,871 depozituesve; si dhe detyrimin për kompensimin e 8.1 mld lekë depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, apo të 22,205 depozituesve. Në totalin e detyrimeve të Agjencisë, prej 929.1 mld lekë, ndaj depozituesve që kanë vendosur depozitat e tyre në banka dhe SHKK, 99.1% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë vendosur depozitat e tyre në banka, ndërsa 0.9% është detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë të vendosura depozitat e tyre në shoqëritë e kursim-kreditit. Agjencia kompenson plotësisht 92.9% të depozituesve në banka dhe 91% të depozituesve në SHKK.


Depozituesi në çdo bankë sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërsa depozituesi në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre.



3.2. Sigurimi i depozitave në banka.

Gjatë vitit 2024, totali i depozitave të sistemit bankar ka pasur ecuri pozitive. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 4.9 %, që i korrespondon një rritjeje në vlerë absolute prej 78.2 mld lekë.

Ecuria e depozitave të sistemit bankar për fund vitet 2002-2024



3.2.1. Depozitat e sigurueshme¹ në sistemin bankar.

Në fund të vitit 2024, vlera e depozitave të sigurueshme që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,590.2 mld lekë, duke përfaqësua 94.5% të totalit të depozitave. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 5.2 %, ndërsa rritja në vlerë absolute është 78.9 mld lekë. Depozitat e sigurueshme përfshijnë depozitat me afat, llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimit, llogaritë e kartave, llogaritë e përbashkëta dhe produkte të tjera të ngjashme.


Depozitat e sigurueshme në euro të shprehura në kundërvlerën në lek, në fund të dhjetorit 2024, zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme prej 47.4%, ndjekur nga

¹ Ligji nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar përcakton se "depozitë e sigurueshme" është vlera e agreguar e të gjitha depozitave të një depozituesi, përfshirë interesin e përllogaritur të tyre në ditën e vlerësimit ose të ndërhyrjes në një subjekt anëtar të skemës, përveç përjashtimeve të nenit 32 të këtij ligji.



depozitat në lekë me 46.9%, dhe nga depozitat në USD me kundërvlerën e tyre në lekë, me 4.1%.

Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave




Ecuria e depozitave të sigurueshme në lekë gjatë vitit 2024 ka qenë pozitive në tetë muaj të periudhës, por normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të vogla, kurse një rënie relativisht të lehtë ka patur në muajt shkurt, mars, prill, e gusht. Norma më e madhe e ndryshimit mujor pozitiv ishte në fund të muajit dhjetor prej +2.8%. Në këtë periudhë këto depozita arritën vlerën prej 745.9 mld lekë.

Depozitat e sigurueshme në valutë në muajin dhjetor 2024 përbëjnë 53.1 % të totalit të depozitave të sigurueshme dhe kundërvlera e tyre në lekë ishte 844 mld lekë. Norma pozitive e ndryshimit mujor për depozitat në monedhë të huaj të konvertuara në lekë është evidentuar gjatë shtatë muajve të vitit, kurse një rënie relativisht të lehtë ka patur në muajt shkurt, mars, prill, qershor e tetor. Rritja më e madhe prej 2.9 %, u shënua në fund të muajit gusht, e cila erdhi si rezultat i rritjes së depozitave në euro, ku rritja mujore e tyre në monedhë origjinale ishte 3.8%, kurse kundërvlera e tyre në lekë shënoi rritje 3.2%.





Ecuria e depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave 2014 - 2024



Në fund të dhjetorit 2024, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 567.83 mld lekë (36% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 1,022.3 mld lekë (ose 64% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).

Struktura e depozitave të sigurueshme krahasuar me nivelin e mbulimit 2.5 mln lekë






3.2.1.1. Depozitat e sigurueshme të individëve.

Këto depozita në sistemin bankar më 31 dhjetor 2024 arritën 1,275.4 mld lekë, dhe përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme, konkretisht 80.2 % të tyre (norma e ndryshimit vjetor ishte +5.6%). Peshën më të madhe të depozitave të sigurueshme të individëve e zënë depozitat në lekë me 48.6%, ndjekur nga depozitat në euro me 45.8%. Gjatë vitit 2024 ecuria e depozitave të individëve në lekë ka qenë pozitive pothuajse gjatë gjithë periudhës, dhe me një rënie të lehtë në muajt janar e gusht. Normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të ulta, dhe rritja më e madhe u shënua në muajin shkurt me 0.9%. Ndikimin më të madh në rritjen vjetore prej 5.6% të depozitave të sigurueshme të individëve, e kanë dhënë depozitat në lekë, të cilat shënuan një rritje vjetore prej 7.3%. Në dhjetor 2024, depozitat në monedhë të huaj të shprehura në kundërvlerën në lekë kanë peshën 51.4%, dhe rritja vjetore e tyre ishte 3.9%. Në këtë periudhë depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë arritën shumën prej 584.6 mld lekë, duke shënuar një rritje vjetore në vlerë prej 23 mld lekë (në përqindje +4.1%), kurse në monedhën origjinale u rritën me 10.2%. Këto depozita zënë peshën më të madhe të depozitave të individëve në monedhë të huaj. Gjatë vitit 2024 ecuria e depozitave të individëve në euro ka qenë pozitive gjatë gjithë periudhës, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë ecuria ka qenë në të dyja kahet pozitive dhe negative, si rezultat i ecurisë së kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros. Rritja më e madhe mujore u shënua në muajin gusht me 2.2%, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë u rritën me 1.6%.

Depozitat e individëve në USD në monedhën origjinale, krahasuar me fundin e vitit 2023, u rritën me 4.6 %, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë (pesha e tyre 3.7%) kanë shënuar rritje vjetore me 4.9 % .



Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të individëve të sistemit sipas monedhave



Gjatë vitit 2024, ecuria e depozitave të sigurueshme të individëve deri në nivelin e mbulimit ka qenë pothuajse pozitive. Në fundin e vitit 2024, depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë kanë një peshë prej 42% kundrejt totalit të depozitave të sigurueshme të individëve dhe krahasuar me fundin e vitit 2023, shënuan një rritje vjetore prej 5.2%. Kurse depozitat me shuma mbi nivelin e mbulimit, krahasuar me fundin e vitit 2023 janë rritur në vlerë absolute me rreth 41 mld lekë (ose 5.9%), duke ndikuar në rritjen vjetore prej 5.6% të depozitave të sigurueshme të individëve.

Numri i depozituesve individë që sigurohen nga skema e sigurimit të depozitave në sistemin bankar, në fund të vitit 2024 është 2,787,539². Në këtë numër janë përfshirë edhe depozituesit me balancë 0 deri në 100 lek (minimumi ligjor për kompensim), të cilët në dhjetor 2024 janë 949,969.


Ndër depozituesit individë me depozita më të mëdha se 100 lekë, 93.1% prej tyre ose 1,711,695 depozitues, i kanë depozitat deri në nivelin e mbulimit dhe përfitojnë mbulim të plotë nga skema e sigurimit të depozitave. Shuma e depozitave që u korrespondon këtyre depozituesve arriti

² Numri total i depozituesve është përcaktuar duke mbledhur të dhënat e agreguara të raportuara nga çdo bankë, kështu që një person i cili ka depozita në disa banka është regjistruar disa herë.




vlerën 535.9 mld lekë. Depozituesit individë me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë në fund të dhjetorit 2024 janë 125,875 dhe shuma e depozitave të tyre arriti vlerën 739.5 mld lekë.

Ecuria e numrit të depozituesve individë të klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2014-2024



■ Nr. i depozituesve individë me depozita > 2.5 mln lekë ■ Nr. i depozituesve individë me depozita ≤ 2.5 mln lekë

Ecuria e numrit të depozituesve individë të klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2014-2024 në %




■ % e numrit të depozituesve individë me depozita mbi 2.5 mln lekë ■ % e numrit të depozituesve individë me depozita deri në 2.5 mln lekë



Për periudhën 2014-2024, përqindja e depozitave të individëve me vlerë deri në 2.5 mln lekë, varion nga 40% deri në 44% të totalit të depozitave të sigurueshme.

Ecuria e depozitave të individëve të klasifikuara sipas nivelit të mbulimit 2014-2024 në %



■ Depozitat e sigurueshme të individëve me vlerë > 2.5 mln lekë ■ Depozitat e sigurueshme të individëve me vlerë ≤ 2.5 mln lekë


3.2.1.2. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.

Për sistemin bankar, këto depozita në dhjetor 2024 arritën 314.8 mld lekë dhe gjatë vitit u rritën me 3.8%. Depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë u rritën me 9.9 %, dhe pesha e tyre kundrejt totalit depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare ishte 10.2%, kurse depozitat me shuma mbi 2.5 mln lekë (me peshë 89.8%), u rritën me 3.2 %.

Sipas llojit të monedhës, depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë peshën më të madhe të depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare prej 53.9%, dhe shënuan një rritje vjetore me 4.9%, kurse në monedhën origjinale u rritën me 11%. Gjatë vitit 2024 depozitat në euro në monedhën origjinale kanë patur ndryshim mujor pozitiv vetëm në muajt prill, korrik, gusht e shtator dhe rritjen më të madhe e shënuan në muajin gusht me 9.4%. Depozitat në lekë zënë një peshë prej 39.9%, dhe shënuan një rritje vjetore me 6.6%, duke dhënë ndikimin më të madh në rritjen vjetore të depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare. Depozitat në USD të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë një peshë prej 5.6%, dhe shënuan një rënie vjetore me -17.2%.




Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare sipas monedhave



Sipas kategorisë së produkteve, peshën më të madhe të depozitave të sigurueshme për depozituesit tregtarë e shoqëritë tregtare e zënë llogaritë rrjedhëse, me 88%.

Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të tregtarëve & shoqërive tregtare sipas produkteve






Në ndryshim nga situata e depozitave të sigurueshme të individëve, 89.8% e depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare janë me shuma mbi nivelin e mbulimit, dhe u korrespondojnë 15,435 depozituesve, të cilët përfaqësojnë 8.1% të depozituesve tregtarë e shoqërive tregtare. Pesha e kësaj kategorie depozituesish (me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë) si në numër ashtu edhe në shumë, në dhjetor 2024 është pothuajse e njëjtë me fundin e vitit 2023.

3.2.2. Depozitat e siguruar në sistemin bankar³.

Në fund të vitit 2024 depozitat e siguruar në sistemin bankar arritën vlerën 921.1 mld lekë. Depozitat e siguruar përbëjnë 54.7% të totalit të depozitave në sistemin bankar dhe 57.9% të depozitave të sigurueshme.

Ecuria e depozitave të sigurura në raport me totalin e depozitave dhe depozitat e sigurueshme - 2014-2024



Rritja vjetore e depozitave të siguruar nga viti 2023 në vitin 2024 ishte 5.4%. Ndërkohë, për 10 vitet e fundit (2015-2024) rritja mesatare vjetore është në masën 4.9%.


³ Ligji nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar përcakton se "depozitë e siguruar" është pjesa e depozitës së sigurueshme e një depozituesi, e cila mbulohet me sigurim nga Agjencia.




3.2.2.1. Depozitat e siguruarat të individëve.

Depozitat e siguruarat të individëve për sistemin bankar në fund të dhjetorit 2024 ishin në vlerën 850.6 mld lekë dhe përbëjnë 67% të vlerës së depozitave të sigurueshme të individëve.

Ecuria e depozitave të siguruarat të individëve në vlerë dhe ndryshimi vjetor në % 2014– 2024




Ecuria e depozitave të siguruarat të individëve në vlerë gjatë vitit 2024






Ecuria e depozitave të siguruara të individëve kundrejt depozitave të sigurueshme 2014-2024



3.2.2.2. Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare.

Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare gjatë vitit 2024 u rritën me 8.2% dhe në fund të këtij viti arritën vlerën prej 70.5 mld lekë. Ecuria e këtyre depozitave gjatë vitit 2024, ka qenë në të dy kahet pozitive e negative, ku rritjen më të madhe e shënuan në muajin korrik me 4.4%, kurse rënie më madhe e shënuan në muajin mars përkatësisht me -1.6%.

Ecuria e depozitave të siguruara të tregtarëve & shoqërive tregtare në vlerë gjatë vitit 2024






3.3. Sigurimi i depozitave në SHKK.

Totali i depozitave të SHKK-ve, në fund të vitit 2024 arriti në 11.5 mld lekë, nga 10.9 mld lekë që ishte në fund të dhjetorit 2023. Depozitat në SHKK në fund të vitit 2024 kanë regjistruar një rritje vjetore në masën 5%, krahasuar me 6% që është regjistruar në vitin 2023. Ndryshimi mujor në përqindje i depozitave përgjatë vitit 2024 është luhatur në intervalin -0.1% deri në 1% krahasuar me intervalin -0.9% deri në 3% përgjatë vitit 2023. Përgjatë vitit 2024 në pak muaj janë regjistruar rënie të lehta të totalit të depozitave deri në -0.1%, por përgjithësisht për pjesën më të madhe të vitit ritmet e rritjes kanë regjistruar trend të lehtë pozitiv që shkon deri në 1%.


Ecuria e depozitave të SHKK-ve gjatë vitit 2024





Në fillimin e aktivitetit të SHKK-ve si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave (janar 2017) kjo shumë ishte 4.1 mld lekë dhe krahasuar me këtë vlerë totali i depozitave në fund të vitit 2024 është 2.8 herë më i lartë. Norma mesatare e ndryshimit vjetor për gjatë aktivitetit të tyre 8 vjeçar si anëtare të skemës së sigurimit rezulton 14.4%.

Ecuria e depozitave të SHKK-ve gjatë periudhës janar 2017-dhjetor 2024



3.3.1. Depozitat e sigurueshme në SHKK.


Këto depozita në fund të dhjetorit 2024 janë 11.3 mld lekë dhe zënë 98,4% të totalit të depozitave, kundrejt 10.8 mld lekë që ishin më datë 31 dhjetor 2023. Këto depozita i korrespondojnë 44,270 depozituesve të SHKK-ve, kundrejt 42,763 depozituesve që përfitonin nga skema e sigurimit të depozitave më datë 31 dhjetor 2023.



Depozitat e sigurueshme në fund të dhjetorit 2024, janë rritur me 4.8% krahasuar me një vit më parë ndërkohë që për vitin 2023 këto depozita janë rritur me 6.2% krahasuar me vitin 2022.

Në rritjen vjetore të depozitave të sigurueshme ndikim më të madh ka patur rritja e depozitave në lekë. Depozitat në lekë zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme të SHKK-ve. Rritja vjetore e tyre është 5.4%.

Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2024




Depozitat në monedhë të huaj zënë 22.8% të totalit të depozitave të sigurueshme, si rezultat i faktit që vetëm një pjesë e SHKK-ve kanë depozita në valutë.

Në fund të dhjetorit 2024, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 4 mld lekë (e shprehur në përqindje 36% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 7.3 mld lekë (ose 64% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).



Struktura e depozitave të sigurueshme krahasuar me nivelin e mbulimit 2 mln




Shuma e vlerësuar për kompensim për depozitat që mbulohen pjesërisht është 4.1 mld lekë, dhe përbën 55% të totalit të depozitave të sigurueshme mbi 2 mln lekë, dhe 36% të totalit të depozitave të sigurueshme në shoqëritë e kursim kreditit.

Gjatë vitit 2024, përqindja e depozitave të sigurueshme me vlera deri në 2 mln lekë, kundrejt totalit të depozitave të sigurueshme, për periudhat tremujore është pothuajse konstante prej 36%.

3.3.2. Depozitat e siguruar në SHKK.

Në fund të vitit 2024, depozitat e siguruar në SHKK janë 8.1 mld lekë. Kjo shumë përbën 70% të totalit të depozitave, ose 71% të depozitave të sigurueshme.


Ecuria e depozitave të siguruar gjatë vitit 2024






Numri i depozituesve që i kanë depozitat 101-2 mln lekë në fund të dhjetorit 2024 është 20,195, dhe krahasuar me fundin e vitit 2023 ka shënuar një rritje prej 16.8%. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i depozituesve të rinj të SHKK-ve gjatë vitit 2024, por edhe nga rregullimet lidhur me raportimet statistikore të tyre, në zbatim të rekomandimeve të lëna në raportet e verifikimeve të Agjencisë. Këta depozitues përbëjnë 91% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave. Numri i depozituesve që i kanë depozitat në vlerën mbi 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2024 është 2,010 dhe këta përbëjnë 9% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema.

Ecuria e numrit të depozituesve të siguruar gjatë vitit 2024






Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të ASD-së.

4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.

4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Në 31 dhjetor 2024, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 400 milion lekë dhe fitimet e akumuluar ndërvite, është 70.141 miliard lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me rreth 6.5 miliard lekë ose 10.3%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e fondit të sigurimit të depozitave për periudhën 2014 – 2024.


Fondi i sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)




4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Madhësia e fondit të sigurimit të depozitave në banka përcaktohet nga të ardhurat neto nga aktiviteti ndërvite. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në banka janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me Ligjin “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, duke filluar nga viti 2015, primi i sigurimit të depozitave përlllogaritet në baza tremujore dhe jo më vjetore. Për bankat primi tremujor i sigurimit përlllogaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm dhe për SHKK-të primi tremujor i sigurimit përlllogaritet si 0.075% e mesatares aritmetike të



shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Primi tremujor i sigurimit për subjektet anëtare të skemës së sigurimit paguhet jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.




Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2024 ishin 4.39 miliard lekë ose 5.4% më të larta se në vitin 2023. Të ardhurat nga primet e sigurimit përgjatë periudhës 2014 – 2024 kanë qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruara në sistemin bankar në këto vite.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2024 ishin 2.83 miliard lekë ose 20.7% më shumë se në vitin 2023. Ky zë të ardhurash përgjatë periudhës 2014 – 2024 ka qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të letrave me vlerë. Gjatë vitit 2024 normat e interesit kanë qenë konstante krahasuar me një vit më parë, me një tendencë rënie të lehtë. Rritja e të ardhurave për vitin 2024 vjen kryesisht nga rritja në nominal e portofolit dhe nga të ardhurat për investimet mbi një vit të realizuara gjatë viteve të mëparshme. Gjatë këtyre viteve gjithashtu Agjencia ka synuar të realizojë një diversifikim të portofolit në disa maturitete, çka ka ndikuar në rritjen e të ardhurave.




Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)




4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka.

Në fund të vitit 2024, depozitat e siguruara në sistemin bankar ishin 921.1 miliard lekë ose 5.4% më të larta se një vit më parë. Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka dhe ecuria më e moderuar e depozitave të siguruara në sistemin bankar gjatë periudhës 2014 – 2024 kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të raportit të mbulimit gjatë këtyre viteve. Në fund të vitit 2024, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 7.61%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në sistemin bankar dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2014 – 2024.

Raporti i mbulimit për depozitat e siguruara në banka (në mijë lekë)






4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK.

4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.

Në përputhje me Ligjin 'Për sigurimin e depozitave', i ndryshuar, në janar të vitit 2015, u arkëtua nga Buxheti i Shtetit fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK në vlerë 76 milion lekë. Ky fond, siguroi bazën fillestare financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK. Duke nisur nga viti 2015 e në vazhdim, Agjencia ka administruar mjetet financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, të cilat hynë në skemë në janar 2017. Në 31 dhjetor 2024, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 76 milion lekë, dhe fondi i akumuluar i përbërë nga primet dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare, është rreth 256.87 milion lekë duke shënuar një rritje prej 15.3% krahasuar me vitin 2023.

Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK (në mijë lekë)



4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.


Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, subjektet të cilat u pranuan për të hyrë në skemë nga janari 2017, filluan të derdhin primet tremujore të sigurimit.




Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2024 ishin 23.49 milion lekë e cila krahasuar me vitin 2023 është rritur me 6.22 %.


Primet e sigurimit në SHKK (në mijë lekë)



Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK përgjatë gjithë vitit 2024 ishin në shumën 10.92 milion lekë, e cila krahasuar me vitin 2023 është rritur me 22.71 %. Këto të ardhura janë pasojë e investimeve të fondit nga Agjencia, gjithashtu vitet e fundit është rritur portofoli i investimeve në tituj më maturitet më të lartë se dy vite, gjë e cila ka sjellë ndikim në rritjen e të ardhurave.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK (në mijë lekë)






4.2.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në SHKK.

Në fund të vitit 2024, depozitat e siguruara për SHKK-të ishin rreth 8.05 miliard lekë ose 3.5% më të larta se një vit më parë. Në fund të vitit 2024, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 3.19%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në SHKK-të dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2017 – 2024.

Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në SHKK (në mijë lekë)



4.3. Administrimi i mjeteve financiare.


Më 31 Dhjetor 2024, mjetet financiare të Agjencisë për fondin Banka, janë në vlerë nominale 69.39 miliard lekë, nga të cilat 60.31 miliard lekë janë të investuara në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare në monedhën lekë, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë dhe 9.08 miliard lekë në monedhën euro nga të cilat, 4,02 miliardë lekë në letra me vlerë të qeverisë shqiptare në tregun ndërkombëtar dhe 5.03 miliardë lekë në bondet e qeverive evropiane dhe gjendje në llogari pranë bankës kujdestare Raiffeisen Bank International. Administrimi i mjeteve financiare të Agjencisë është në përputhje me limitet e përcaktuara në rregulloren “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”.



Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit në fund të vitit 2024 kishte 12.55% të portofolit në instrumente shumë likuid, si letra me vlerë në maturitet të mbetur deri në 3 muaj, depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë dhe në disa banka ku Agjencia mban llogari për aktivitetin operacional si edhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë.

Mjetet financiare të fondit janë në masën më të madhe në lekë. Agjencia mban edhe një pjesë të mjeteve financiare të fondit në valutë Euro. Në përputhje me Rregulloren “Për politikën e investimeve”, investimet në monedhë të huaj përbëjnë 13.09% të mjeteve financiare nën administrim dhe në planin afatgjatë synohet afrimi i strukturës sipas monedhës për portofolin e fondit me atë të depozitave të siguruara. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të fondit sipas valutës më 31 Dhjetor 2024.


Mjetet financiare sipas valutave




Në grafikun që vijon paraqitet shpërndarja e mjeteve financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim më 31 Dhjetor 2024. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, mjetet financiare kanë një shpërndarje të shkallëzuar sipas kohëzgjatjes deri në maturim. Agjencia ka zhvendosur rreth 53.93% të portofolit të investimit në instrumente me maturitet të mbetur nga 3- 24 muaj dhe rreth 33.52% të portofolit në instrumente me maturitet të mbetur mbi 24 muaj.



Mjetet financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim



Më 31 Dhjetor 2024, mjetet financiare të Agjencisë për fondin e Shoqërive të Kursim Kredit me vlerë nominale 256,31 milion lekë, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me Rregulloren “Për politikën e investimeve” në fund të vitit 2024 kishte 19.43% të portofolit në instrumente shumë likuid, si depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë. Dhe pjesën tjetër të portofolit të investuar në maturitet 12 muaj deri në 15 vite. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të fondit sipas transheve më 31 Dhjetor 2024.





Seksioni 5 – Plani Strategjik 2024-2026 dhe aktivitete për vitin 2024.

5.1. Plani Strategjik 2024-2026.

Në vijim të përfundimit të Planit Strategjik 2021-2023, Agjencia hartoi strategjinë afatmesme të zhvillimit të institucionit për periudhën 2024 – 2026, a cila u miratua nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 2, datë 30.01.2024.

Të gjithë prioritetet dhe iniciativat e përfshira në këtë dokument strategjik janë përcaktuar në funksion të përmbushjes së objektivave ligjorë të parashikuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar. Në këtë drejtim, Plani Strategjik 2024 – 2026 evidenton tre prioritete strategjike kryesore, të cilat synojnë rritjen dhe forcimin e kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë për përmbushjen e objektivave institucionale; garantimin e komunikimit efektiv me grupet e interesit përmes ndërveprimit me anëtarët e skemës dhe aktorë të tjerë të identifikuar; si dhe harmonizimin në vazhdimësi me legjislacionin evropian, në kuadër të Programit Kombëtar për Aderimin në BE (PKABE).

Për realizimin e këtyre prioritetëve parashikohen një sërë objektivash dhe iniciativash strategjike të cilat do të ndërmerren në këto tre vjet nga strukturat e Agjencisë. Tërësia e këtyre prioritetëve strategjike është thelbësore për përmbushjen e objektivave publikë të skemës së sigurimit të depozitave, për kompensimin e saktë dhe në kohë të depozituesve të siguruar si dhe për kontributin në stabilitetin financiar në vend.

Plani Strategjik 2024-2026 përfshin gjithashtu planin financiar të Agjencisë për të njëjtën periudhë, i cili është hartuar duke marrë në konsideratë analizën historike të treguesve financiarë të Agjencisë, të raportuara sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, si dhe politikën e investimit të mjeteve financiare në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë. Ky planifikim financiar synon të përcaktojë drejtimet kryesore të procesit të buxhetimit në Agjenci për periudhën afat-mesme.

Për vitin 2024 njësitë organizative në Agjenci kanë kryer një sërë aktivitete dhe veprimtarish në përputhje me parashikimet në strategjinë afatmesme. Ndër të tjera, këto iniciativa kanë synuar




testimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve operacionale, financiare dhe infrastrukturore të Agjencisë; testimi i kapaciteteve të subjekteve anëtare të skemës për të raportuar saktë dhe në kohë paraqitjen unike të depozituesve; rritjen e nivelit të gatishmërisë së fondeve të administruara nga Agjencia për një ngjarje të mundshme sigurimi dhe përmirësimin e operacionalizimit të infrastrukturës të brendshme të teknologjisë së informacionit; si dhe rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit nënligjor të Agjencisë që rregullon procesin e sigurimit dhe kompensimit të depozitave, etj.

Njëkohësisht me kryerjen e simulimeve teknike, Agjencia është angazhuar edhe në ndjekjen e platformës për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar. Për zbatimin e këtij plani të përbashkët, që përfshin edhe bankat anëtare të skemës, Agjencia monitoroi përmirësimin e cilësisë së të dhënave nga bankat anëtare të skemës, si nëpërmjet procesit të raportimit, po kështu edhe nëpërmjet proceseve të verifikimit.

Në drejtim të rritjes së aftësive reaguese të Agjencisë në raste të situatave të jashtëzakonshme Agjencia, gjatë vitit 2024, Agjencia u angazhua në kryerjen e aktiviteteve për rishikimin e Planit të Vijueshmërisë së Biznesit (Business Continuity Plan) në drejtim të detajimit të mëtejshëm të funksionalitetit të tij, si dhe për implementimin e qendrës së dytë funksionale për sistemet IT (Disaster Recovery Site).

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, në drejtim të objektivit për harmonizimin në vazhdimësi me legjislacionin evropian në kuadër të PKABE, Agjencia ka bashkëpunuar me Bankën e Shqipërisë dhe misionin e asistencës teknike të FinSAC të Bankës Botërore për propozimet e pritshme në kuadër të reformimit të kornizës rregullatore të Bashkimit Evropian për menaxhimin e krizave financiare, si dhe për skenarët e mundshëm të pjesëmarrjes së Agjencisë nëpërmjet transferimit të fondit të kompensimit të depozitave në banka në rast ndërhyrjeje të jashtëzakonshme.

Veçanërisht, asistenca teknike e FinSAC ka qenë thelbësore për identifikimin e çështjeve të reformës ligjore që po ndërmerret në Bashkimin Evropian në lidhje me sigurimin e depozitave, si dhe veprimtarinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, si një funksion kritik të menaxhimit të krizave në sektorin bankar e financiar.



Gjatë vitit 2024, ASD ka kontribuar në raportimin në kapitullin 9 në kuadër të planifikimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2025-2027, si dhe të Planit Menaxherial të Integritimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE). Gjithashtu, ASD ka kontribuar në hartimin e pozicionit negociues të kapitullit 9.

Performanca e strukturave të Agjencisë përgjatë të gjithë periudhës së strategjisë afat-mesme dhe përkundrejt objektivave strategjikë të përcaktuar është objekt raportimi, vlerësimi dhe rishikimi periodik nga strukturat drejtuese të Agjencisë.


Plani Strategjik 2024-2026 është publikuar në faqen zyrtare të internet të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

5.2. Aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut dhe edukimin financiar.

Ndërgjegjësimi i publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave si dhe rolin dhe funksionet e Agjencisë e Sigurimit të Depozitave si dhe kontributi për edukimin financiar të grupeve të identifikuara të interesit vazhdon të jetë në fokus të veprimtarive kyçe të ASD-së. Për këtë qëllim kemi qenë të angazhuar në aktivitete dhe veprimtari informative apo edukative, të cilat gjykojmë se kanë kontribuar në një rritje të nivelit të mëtejshme të nivelit të informimit të depozituesve për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri.

5.2.1. Pjesëmarrje në aktivitetet e edukimit financiar.

Angazhimet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në fushatat që kanë për qëllim edukimin financiar janë rritur nga viti në vit. Agjencia ka zhvilluar aktivitete në mënyrë të pavarur por edhe bashkëpunime të suksesshme me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave. Kontributi i Agjencisë kryesisht në aktivitete që kanë lidhje me pjesëmarrjen e brezit të ri është vlerësuar i nevojshëm jo vetëm për rëndësinë e madhe që ka edukimi i grup moshave të reja, por edhe si një mundësi bashkëveprimi me një nga grupet e synuara të përcaktuara në Strategjinë e Komunikimit të institucionit.



Në këtë kontekst, duke vlerësuar që kultura/edukimi financiar duhet të fillojë që në moshë të hershme, edhe gjatë vitit 2024 ishim pjesë aktive e Javës së Parasë, që është një festë mbarë botërore e parasë e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë




vendime financiare të mirëmenhuara. Në këtë aktivitet, të organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave, Agjencia ishte kontribuese në një nga aktivitetet e organizuara në këtë kuadër, që është Kuizi Evropian i Parasë. Prej vitesh Agjencia e mbështet dhe e inkurajon zhvillimin e Kuizit të Parasë, jo vetëm sepse fëmijët e moshës 13-15 vjeç kanë mundësinë të ballafaqojnë njohuritë e tyre në fushën e ekonomisë dhe financës, por edhe sepse ky format është një konkurs mbarë evropian që i jep mundësinë nxënësve fitues të konkurrojnë në finalen e madhe që organizohet në Bruksel me pjesëmarrjen e nxënësve fitues të çdo shteti pjesëmarrës. Në Kuizin Evropian të Parasë u regjistruan 1010 nxënës të grup moshës 13-15 vjeç nga 98 shkolla nga i gjithë vendi. Konkursi u realizua online dhe u ndoq me interes të lartë nga më tepër se 9,800 shikues. Pjesëmarrësit konkurruan në platformën online Kahoot.

5.2.2. Leksione të hapura.

Edhe përgjatë vitit 2024 Agjencia vijoi bashkëpunimin me universitetet për të zhvilluar leksione të hapura me studentët, konkretisht në Universitetin New York Tirana dhe në Universitetin Luarasi-Fakulteti i Ekonomisë. Leksionet u ndoqën nga studentë të degëve Bachelor dhe Master. Synimi ynë ishte jo vetëm transmetimi i





njohurive bazë për skemën e sigurimit të depozitave por edhe për të kuptuar funksionin dhe ndikimin e saj në tregun bankar dhe në stabilitetin financiar në vend.


Gjithashtu në bashkëpunim me SHSHB realizuam disa seanca trajnimi me nxënësit të cilët konkuruan në Olimpiadën Kombëtare të Ekonomisë dhe më pas në Olimpiadën Botërore të Ekonomisë (International Economics Olympian (IEO)). Nxënësit u trajnuan dhe iu përcoll informacion lidhur me skemën e sigurimit të depozitave në vend, me skemat e sigurimit të depozitave në botë, dhe ndikimin e tyre në stabilitetin financiar dhe bankar të vendit.

5.2.3. Promovim i skemës përmes informimit për depozituesit në degët e bankave.

Edhe gjatë vitit 2024 Agjencia ka vijuar promovimin e skemës edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve të saj promociionale në ambientet e bankave si fletë palosje, etiketa informative me logon e ASD-së, broshura, me informacion rreth skemës së sigurimit të depozitave në vend, dhe videove me tematikë që Agjencia ka prodhuar për skemën e sigurimit të depozitave në vend.

5.3. Aktivitete në rrafshin ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me organizma dhe institucione ndërkombëtare vlerësojmë se është një element i domosdoshëm me qëllimin për të përfituar nga eksperiencat më të mirat në fushën e sigurimit të depozitave. Për këtë qëllim gjatë vitit 2024, në kuadër të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare të sigurimit të depozitave si IADI dhe EFDI ashtu edhe në funksion të protokolleve të nënshkruara me institucione homologe, kemi pasur një angazhim proaktiv si më poshtë vijon.




5.3.1. Kontributi në forumet ndërkombëtare.

Agjencia ndjek zhvillimet evropiane dhe botërore lidhur me sistemet e sigurimit të depozitave dhe menaxhimin e krizave financiare, dhe merr pjesë në aktivitete të ndryshme që synojnë shkëmbimin e ndërsjellët dhe të vazhdueshëm të përvojave institucionale. Në vijimësi të bashkëpunimeve afatgjata me shoqatat e sigurimit të depozitave, me organizma të tjera financiare ndërkombëtare dhe me homologët, kapacitetet e Agjencisë janë zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme duke qenë tashmë jo vetëm përfitues por edhe kontribues në forumet ndërkombëtare.



Në këtë drejtim në vitin 2024 Agjencia mikpriti dhe organizoi në bashkëpunim me Forumin Evropian të Siguruesve të Depozitave (EFDI), një aktivitet dy ditor të suksesshëm dhe gjithëpërfshirës të disa grupeve të punës së këtij forumi. Më konkretisht u zhvilluan takimet e anëtarëve të Grupit të Punës të EFDI për Realizimin e Stres Testeve (GPST), Komitetit të Marrëdhënieve me Publikun (KMP) dhe Nëngrupit të Komunikimit Ndërkufitar (NKD). Pjesëmarrësit në këto takime ofruan qasjet dhe eksperiencat e organizatave që ata përfaqësonin në lidhje me tematika thelbësore për sigurimin dhe kompensimin e efikas të depozitave, siç janë ushtrimet e stres testeve për të verifikuar aftësinë e reagimit të siguruesit të depozitave ndaj situatave kritike, komunikimi efikas me depozituesit dhe marrëdhëniet ndërkufitare ndërmjet autoriteteve të sigurimit të depozitave për adresimin e situatave problematike financiare në institucione financiare që e shtrijnë aktivitetin në juridiksione të ndryshme.



5.3.2. Bashkëpunimi me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Hungarisë.

Bazuar në marrëveshjen dypalëshe të bashkëpunimit, e cila synon shkëmbimin e informacionit dhe përvojës profesionale në fushën e sigurimit të depozitave dhe financimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave të Hungarisë (OBA) zhvilluan vizita të ndërsjella studimore në muajt maj dhe tetor 2024.



Duke marrë në konsideratë statusin si vend anëtar i EU-së si dhe ngjashmërinë strukturore dhe operacionale që ASD ka me OBA, krahas çështjeve me karakter teknik me interes reciprok, pjesë të diskutimeve ishin stadi aktual dhe progresi i pritshëm i propozimeve për ndryshime në kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian për menaxhimin e krizave financiare dhe sigurimin e depozitave si dhe hapat e ndërmarra nga ASD për përputhshmërinë e kuadrit ligjor me Direktivat e BE-së.

Krahas çështjeve që lidhen me anëtarësimin në BE, ekspertët e të dy autoriteteve shqyrtuan, ndër të tjera, mundësitë e avancimit të teknologjisë së informacionit në procedurat e kompensimit të depozitave, çështjet aktuale të sigurisë së informacionit lidhur me sigurimin e depozitave, duke përfshirë në veçanti çështjet e sigurisë kibernetike, ndryshimin e rolit të institucioneve të sigurimit të depozitave në rrjetin e sigurisë financiare, në lidhje me masat parandaluese dhe alternative, si dhe roli i sigurveuesve të depozitave në procesin e likuidimit të subjekteve anëtare të skemës.



Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh, çështjet pjesë e diskutimeve përfshinin tematika që lidheshin me zgjidhjet e ndërmarra për procese efikase kompensimi, bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve pjesë të rrjetit të sigurisë financiare, përmirësimin e praktikave për ngritjen e infrastrukturës mbështetëse për sigurimin e vazhdimësisë së operacioneve, etj.

Marrëdhënia institucionale ndërmjet të dy institucioneve vlerësohet si mjaft produktive dhe për këtë qëllim ASD dhe OBA janë të angazhuar që të vijojnë me bashkërendimin dhe ekzekutimin e protokolleve të bashkëpunimit në funksion të çështjeve të identifikuara me interes të përbashkët.

5.3.3. Bashkëpunimi me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Kosovës.

Në muajin shtator 2024, ASD mirëpriti në një vizitë mirëseardhëse një delegacion të FSDK-së. Delegacioni i FSDK kryesohej nga Znj. Shqipe Devaja, e cila ishte emëruar rishtazi në pozicionin e Drejtores Menaxhuese të FSDK-së. Me këtë rast, Z. Genci Mamani, Drejtor i Përgjithshëm i ASD-së, i uroi Znj. Devaja mirëseardhjen dhe sukses në detyrën e saj të re duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbështetjen e mëtejshme për fuqizimin e sistemit të sigurimit të depozitave.



Gjatë vizitës, të dy institucionet diskutuan mbi zhvillimet e fundit në të dy juridiksionet si dhe zhvillimet evropiane mbi reformat e pritshme të fushës së sigurimit të depozitave. Në përfundim të vizitës, bazuar në protokollet në fuqi të bashkëpunimit, të dy institucionet u përkushtuan për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit me synimin të avancimit të sistemeve të sigurimit të depozitave me standardet evropiane si dhe me standardet ndërkombëtare.



Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës.

6.1. Këshilli Drejtues.

Bazuar në Ligjin nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar dhe Statutin e Agjencisë, Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, përgjegjës për kryerjen edhe mirëfunksionimin e aktiviteteve dhe veprimtarisë së Agjencisë. Roli i Këshillit Drejtues përqendrohet në përgjegjësitë e tij mbikëqyrëse, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe duke vlerësuar performancën e drejtimit të Agjencisë përkundrejt kërkesave ligjore, rekomandimeve të institucioneve kushtetuese (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë) dhe mbikëqyrëse (Banka e Shqipërisë), në të cilat Agjencia raporton, si dhe objektivave të përcaktuara në aktet rregullative të Agjencisë. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutivë, me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Këshilli Drejtues i Agjencisë përbëhet nga anëtarët sipas tabelës më poshtë.

KËSHILLI DREJTUES	FUNKSIONI	INSTITUCIONI PROPOZUES
Donald Duraj	Kryetar	Banka e Shqipërisë
Genci Mamani	Anëtar	Banka e Shqipërisë
Adelina Xhemali	Anëtar	Ministri i Financave
Vasilika Vjero	Anëtar	Ministri i Financave
Shkëlzen Margjeka	Anëtar	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)



Bazuar në detyrimin që në çdo kohë të veprojnë me ndershmëri në interesin më të mirë të Agjencisë, anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Rregulloren “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale.


Procesi i vendimmarrjes i Këshillit Drejtues, përgjatë vitit 2024, është udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës. Sipas programit të miratuar për vitin 2024 vendimmarrja e Këshillit Drejtues ka prodhuar 29 vendime në funksion të vendosjes dhe ruajtjes së standardeve të larta në mirëqeverisjen e Agjencisë si dhe konsolidimin e kapaciteteve të saj për të përmbushur mandatin ligjor. Vendimmarrja e Këshillit u përqendrua kryesisht në miratimin e akteve nënligjore me qëllim miradministrimin e skemës së sigurimit të depozitave si dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë operacionale të Agjencisë.

6.2. Struktura organizative.

Struktura organizative e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, i ndryshuar.

Bazuar në Statutin e Agjencisë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018 dhe në zbatim të strukturës së saj organizative Agjencia organizohet në mënyrë hierarkike, drejtohet nga Këshilli Drejtues dhe administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Sipas kësaj strukture Agjencia është e përbërë nga 7 sektorë, dhe ka në total 29 pozicione pune. Organigrama e mëposhtme paraqet organizimin e saj në njësi organizative.



Gjatë vitit 2024, Agjencia ka vijuar me zhvillimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore, duke u fokusuar në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e performancës në vendin e punës. Trajnimet e organizuara kanë synuar jo vetëm zhvillimin e aftësive teknike, por edhe forcimin e kompetencave menaxheriale, komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Në kuadër të kësaj qasjeje, punonjësit kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në një sërë programesh trajnimi të zhvilluara si brenda ashtu dhe jashtë vendit të organizuara nga institucione ndërkombëtare si EFDI, IADI, apo institucione të tjera homologe.

Agjencia synon që nëpërmjet menaxhimit me efektivitet të burimeve njerëzore të saj të arrijë një nivel sa më optimal të kapaciteteve profesionale, si edhe të orientojë përdorimin me sa më shumë efikasitet të këtyre burimeve, sipas politikave të zhvillimit të institucionit, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të saj.



Seksioni 7 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.



Grant Thornton Sh.p.k
Rr. "Sami Frashëri",
Kompleksi T.I.D, Shk. B, Floor 1
1001 Tirana
Albania

T +355 44 626 880
E contact@algt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këshillin Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.


Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ("Agjencia"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave materiale të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2024 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.



Informacione të tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2024 të Agjencisë

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Agjencisë për vitin 2024, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Agjencisë për vitin 2024 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë opinion mbi to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përmdryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Agjencisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Agjencisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabël, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.



Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionet, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Agjencisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshme rinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Agjencisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Agjencisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilat janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

25 mars 2025

Kledion Kodra
[Signature]





Pasqyra e pozicionit financiar.

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	2,096,063,998	1,404,953,188
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale	9	68,253,878,520	62,318,880,652
Aktive afatgjata materiale, neto	10	58,836,072	57,407,985
Aktive afatgjata jo materiale, neto	11	2,027,125	2,562,100
Aktive të tjera, neto	12	4,427,068	5,822,416
TOTALI I AKTIVEVE		70,415,232,783	63,789,626,341
DEYRIMET			
Detyrime të tjera	13	16,580,902	13,923,794
TOTALI I DETYRIMEVE		16,580,902	13,923,794
FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE			
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	14	400,000,000	400,000,000
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në Shoqëri Kursim Krediti ("SHKK")	14	76,000,000	76,000,000
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka		69,741,779,608	63,152,868,055
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK		180,872,273	146,834,492
TOTALI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		70,398,651,881	63,775,702,547
TOTALI I DETYRIMEVE DHE FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE		70,415,232,783	63,789,626,341



Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura operative			
Të ardhura nga primet e sigurimit	15	4,422,317,060	4,193,699,571
Të ardhura nga kontributet fillestare	16	-	-
Të ardhura nga interesat	17	2,843,668,202	2,355,098,483
Të ardhura të tjera operative	18	3,151,927	2,527,926
Totali i të ardhurave operative		7,269,137,189	6,551,325,980
Shpenzime financiare			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(512,960,331)	(659,334,197)
Shpenzime të tjera financiare	19	(6,566,126)	(53,330,176)
Totali i shpenzimeve financiare		(519,526,457)	(712,664,373)
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	20	(89,638,794)	(85,145,313)
Shpenzime administrative	21	(27,173,684)	(29,840,830)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	(8,819,991)	(7,594,865)
Totali i shpenzimeve operative		(125,668,468)	(122,581,008)
Shpenzime provigjionit të instrumentave financiare për të mbledhur flukse kontraktuale		(3,991,848)	-
Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale, neto	8, 9	2,962,918	1,967,558
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN		6,622,949,333	5,718,048,157
Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse			
		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		6,622,949,333	5,718,048,157



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		6,622,949,333	5,718,048,157
<i>Rregullime për:</i>			
Të ardhura nga interesat	17	(2,843,668,202)	(2,355,098,483)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	8,819,991	7,594,865
Lëvizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare	9	(2,952,774)	(1,956,877)
<i>Ndryshimet në:</i>			
Aktive të tjera		1,431,049	22,142,280
Detyrime të tjera		2,657,108	(8,889,990)
Interesi i arkëtuar		2,712,747,607	2,173,201,770
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ		6,501,948,113	5,555,041,722
AKTIVITETI INVESTUES			
Blerje e aktiveve afatgjata	11	(9,712,904)	(4,116,014)
Shtesat e instrumenteve financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale		(5,801,124,498)	(6,128,942,059)
<i>Blerë gjatë vitit</i>		<i>(33,762,830,000)</i>	<i>(29,094,540,000)</i>
<i>Maturuar gjatë vitit</i>		<i>27,961,705,502</i>	<i>22,965,597,941</i>
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues		(5,810,837,403)	(6,133,058,073)
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit		691,110,710	(578,016,351)
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8	1,404,953,188	1,982,969,539
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	8	2,096,063,998	1,404,953,188



Pasqyra e ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave.

	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka	Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në SHKK	Totali
Më 1 janar 2023	400,000,000	76,000,000	57,465,285,509	116,368,881	58,057,654,390
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	5,687,582,546	30,465,611	5,718,048,157
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	5,687,582,546	30,465,611	5,718,048,157
Më 31 dhjetor 2023	400,000,000	76,000,000	63,152,868,055	146,834,492	63,775,702,547
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	6,588,911,553	34,037,780	6,622,949,333
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	400,000,000	76,000,000	69,741,779,608	180,872,273	70,398,651,881



Seksioni 8 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

8.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që ushtron të drejtat e ndërhyrjes të përcaktuara në ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”. Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i janë caktuar kompetencat për administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.


Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme administrohet në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Kontributet e para janë derdhur në fond në Janar 2018. Banka e Shqipërisë përllëgarit çdo vit kontributin vjetor që sektori bankar do të paguajë për arritjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Kontributi vjetor i paguar nga bankat gjatë vitit 2024 ishte 982.1 milion lekë dhe kontributi i paguar në shtatë vite arrin në shumën 5.21 miliard lekë. Në 31 dhjetor 2024, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është 5.73 miliard lekë. Mjetet financiare të Fondit janë investuar në përputhje me strategjinë vjetore të investimit për vitin 2024, miratuar nga Komiteti i Investimeve i Agjencisë. Këto mjete financiare me vlerë nominale 5.67 miliard lekë në fund të 2024, janë të investuara të gjitha në tituj të Qeverisë Shqiptare dhe depozita një javore e llogari rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë. Të ardhurat e Fondit nga administrimi i mjeteve financiare për vitin 2024 kanë qenë 219,6 milionë lekë.

Agjencia ka si prioritet administrimin me efektivitet të mjeteve financiare të këtij fondi. Në fund të vitit 2024, 12.13% e portofolit është investuar në instrumente shumë likuid, si llogari rrjedhëse dhe depozita me Bankën e Shqipërisë dhe tituj me maturitet të mbetur deri në 90 ditë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2024.




Mjetet financiare sipas transheve të investimit



Mjetet financiare të FNJ janë në masën më të madhe në lekë. Në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, investimet në monedhë të huaj përbëjnë 5.24% të mjeteve financiare nën administrim. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas monedhës më 31 Dhjetor 2024.

Mjetet financiare sipas valutave



Për administrimin e Fondit të Ndërhjës së Jashtëzakonshme, Agjencia mban llogari të veçanta kontabël për mjetet financiare të këtij fondi. Agjencia përgatit dhe raporton pranë Autoritetit të Ndërhjës së Jashtëzakonshme portofolin e mjeteve financiare të fondit si edhe pasqyrat financiare tremujore të tij. Pasqyrat Financiare vjetore të Fondit të Ndërhjës së Jashtëzakonshme auditohen nga shoqëri auditimi të çertifikuara e të pavarura.



8.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.



Grant Thornton Sh.p.k
Rr. "Samë Frashëri",
Kompleksi T.I.D, Shk. F, Floor 1
1001 Tirana
Albania

T +355 44 525 880
E contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për drejtuesit e "Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme", Shoqëri Administruese e Fondeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme e krijuar sipas ligjit nr.133/2016 nga Banka e Shqipërisë, për qëllime të zbatimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 dhjetor 2024, pasqyrën të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e Ndryshimeve në Aktivet neto për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit me datën 31 dhjetor 2024, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.



- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirane, Albania

25 mars 2025





Pasqyra e pozicionit financiar.

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	8	686,282,289	482,465,250
Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale	9	5,051,716,011	4,073,140,875
TOTALI I AKTIVEVE		5,737,998,300	4,555,606,125
DETYRIMET			
Detyrime të tjera	10	3,728,441	3,103,928
TOTALI I DETYRIMEVE		3,728,441	3,103,928
Aktivet neto në dispozicion të Autoritetit të ndërhyrjes së Jashtëzakonshme			
Aktivet neto në dispozicion të ANJ		4,552,502,197	3,526,358,883
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		1,181,767,662	1,026,143,314
Totali aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme		5,734,269,859	4,552,502,197
TOTALI I DETYRIMEVE DHE I AKTIVEVE NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME			
		5,737,998,300	4,555,606,125



Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.

TË ARDHURA	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të ardhura operative			
Të ardhura nga kontributi vjetor	11	982,134,585	896,148,191
Të ardhura nga interesat	12	219,572,067	155,688,444
Totali i të ardhurave		1,201,706,652	1,051,836,635
SHPENZIME FINANCIARE			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(15,834,224)	(22,623,591)
Totali i shpenzimeve financiare		(15,834,224)	(22,623,591)
SHPENZIME OPERATIVE			
Shpenzime operative nga aktiviteti	13	(3,728,442)	(3,103,926)
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE		(3,728,442)	(3,103,926)
Rimarrje / Shpenzime provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	8,9	(376,324)	34,196
Teprica neto për vitin		1,181,767,662	1,026,143,314
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		1,181,767,662	1,026,143,314



Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		1,181,767,662	1,026,143,314
Rregullime për:			
Të ardhura nga interesat		(219,572,067)	(155,688,444)
Lëvizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare		-	25,407
Ndryshimet në:			
Detyrime të tjera		624,513	230,830
Interesi i arkëtuar		184,413,331	136,767,452
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar Nga Aktiviteti operativ		1,147,233,439	1,007,478,559
AKTIVITETI INVESTUES			
Blerje e instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale		(943,416,400)	(533,249,007)
Blerë gjatë vitit		(2,200,000,000)	(1,798,823,600)
Maturuar gjatë vitit		<u>1,256,583,600</u>	<u>1,265,574,593</u>
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues		<u>(943,416,400)</u>	<u>(533,249,007)</u>
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit		203,817,039	474,229,552
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8	482,465,250	8,235,698
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	8	686,282,289	482,465,250



Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

	Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme
Aktivet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme më 1 Janar 2023	3,526,358,883
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	1,026,143,314
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	4,552,502,197
Aktivet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2023	4,552,502,197
Teprica neto nga veprimtaria për periudhën	
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	1,181,767,662
Aktivet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme më 31 Dhjetor 2024	5,734,269,859